



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, E
MBAJTUR MË 29 DHJETOR 2020**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 29. DECEMBRA 2020. GODINE**

**DHJETOR - DECEMBAR
2020**

Rendi i ditës

1. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 07/L-041 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021.

Dnevni red

1. Drugo razmatranje Nacrt zakona br. 07/L-041 o budžetskim podelama budžeta Republike Kosova za 2021.godinu.

Mbledhjen e drejtoi kryetarja e Kuvendit, znj. Vjosa Osmani.

KRYETARJA: Të nderuar deputetë,

I hap punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, sipas vendimit të Kuvendit të datës 28 dhjetor 2020.

Më lejoni që t'ju përkujtoj që sërish duhet t'u përmbahemi rregullave që kanë të bëjnë me mbrojtjen nga pandemia.

1. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 07/L-041 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021

Komisioni e ka shqyrtuar projektligjin dhe i ka rekomanduar Kuvendit miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Komisioni për Legjislacion po ashtu i ka rekomanduar Kuvendit që ta miratojë projektligjin.

Komisioni për Integrim Evropian nuk e ka paraqitur raportin brenda afatit të përcaktuar.

Komisioni për Komunitete nuk e ka paraqitur raportin brenda afatit të përcaktuar.

Rrjedhimisht, meqenëse e kanë tejkaluar afatin, neve na lejohet të procedojmë edhe pa këto raporte.

Ftoj fillimisht kryetarin e Komisionit për Buxhet dhe Transfere, zotin Hekuran Murati, që ta paraqes rekomandimin e komisionit, në qoftë se është këtu. A është autorizuar dikush tjetër nga komisioni, apo ta presim zotin Murati. Dikush nga komisionet e tjera të përhershme nuk po shoh që e ka kërkuar fjalën.

Po e thërras përfaqësuesen e Qeverisë atëherë, zonja Bajrami, dëshironi ta merrni fjalën deri sa të vijë kryetari i komisionit? Urdhëroni!

MINISTRJA HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, e nderuar kryetare!

Të nderuar kolegë ministra,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Jemi në leximin e dytë të Buxhetit për vitin 2021. Siç e kemi diskutuar edhe dje situata buxhetore është jashtëzakonisht e rëndë, kriza pandemike, siç duket, do të vazhdojë edhe për tremujorin e ardhshëm të viti 2021.

Ne së bashku ishim në Komisionin për Buxhet dhe Financa, aty nga të gjitha grupet parlamentare u aprovuan disa amendamente që janë si çështje më vitale, për shembull, reflektuam koston e vaksinës, që nuk ka qenë e inkuorporuar në buxhet, sepse në kohën kur e kemi përgatitur buxhetin nuk kanë qenë të aprovuara vaksinat, do të thotë janë 40 milionë plus financim nga jashtë për koston e vaksinës, në mënyrë që të blihen doza për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës.

Gjithashtu kemi trajtuar edhe amendamentet për buxhetet e katër komunave, të cilat nuk e kanë pasur buxhetin e aprovuar në asambljetë komunale dhe disa amendamente të tjera, të cilat kaluan me aprovim të deputetëve të komisionit dhe ne u detyruam t'i gjejmë burimet.

Tani, të nderuar deputetë,

Thirrja jonë si përfaqësues të Qeverisë është që të mos procedohet me amendamente të tjera, për arsye se edhe nëse do të procedohet, nuk do të ketë mundësi të zbatohen për shkak të limiteve buxhetore të cilat ne i kemi.

Është mirë që ndoshta, edhe për kursim të kohës, por prapë këtë e vendosni ju dhe kryetarja bashkërisht, që të votohen në pako si amendamente me përkrahje, si ato pa përkrahje. Po në rast se hyni në votimin e secilit amendament veç e veç, të nderuar deputetë, unë e kam një lutje. Qeveria tanimë i ka të shterura të gjitha burimet e financimit. Nëse propozoni amendament për një projekt shtesë, qoftë ajo organizatë buxhetore në nivelin qendror, në fakt, vetëm nga niveli qendror keni të drejtë, sepse buxheti i komunave nuk u ndryshohet, se është i votuar në asambljetë komunale, atëherë tregoni se ku duhet të shkurtohen ato mjete. Qeveria nuk ka mjete të tjera shtesë.

Ne kishim një kontingjencë në kuadër të Ministrisë së Financave, e cila në Komisionin për Buxhet dhe Financa u shpenzua e tëra. Gjithashtu kemi akomoduar edhe buxhetin për zgjedhjet nacionale, duke shtuar buxhetin të Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, do të thotë ne nuk kemi rezerva të tjera, nuk mund të akomodojmë si Qeveri mjete shtesë. Në qoftë se propozoni amendamente, edhe një herë ju bëj thirrje që të propozohet edhe burimi i financimit, të cilin ju vetë duhet ta caktoni.

Tani, ju vetë e dini, nëse duhet ta shtoni një projekt të ri dhe ta hiqni një, i cili është ekzistent në Projektbuxhetin e vitit 2021.

Në qoftë se kjo nuk ndodh dhe kalojnë amendamente, siç na ka ndodhur edhe më herët, të cilat nuk kanë burim të financimit, atëherë tabelat e buxhetit nuk barazohen. Në qoftë se ne do të kemi shpenzime më të larta se sa pranimet buxhetore, ligji bëhet i pazbatueshëm dhe këto nuk mund të bëhen pjesë të tabelave. Faleminderit shumë edhe një herë për mbështetjen!

KRYETARJA: Zoti Hekuran Murati e ka fjalën.

HEKURAN MURATI: Faleminderit, e nderuar kryetare!

Ne si Komision për Buxhet dhe Transfere, në bazë të Rregullores së Kuvendit në mbledhjen e mbajtur më 29 të këtij muaji kemi shqyrtuar Projektligjin numër 07/L-041 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021 dhe kemi vendosur që amendamentet t'i procedojmë për vlerësim në komisionet e përhershme si në vijim, nga të cilat kemi marrë përgjigje, e amendamentet janë si vijon:

Në pjesën tekstuale të projektligjit e kemi një amendament që ka marrë mbështetjen e komisionit si dhe kemi edhe 11 amendamente të tjera që janë në pjesën tabelare të ligjit, që janë me mbështetje të komisionit. Pra, gjithsej 12 amendamente.

Kurse pjesa tjetër, që në total janë 150 amendamente, hiç këto me përkrahje të komisionit, janë rreth 138 amendamente që janë pa përkrahjen e komisionit.

Ne si komision, duke marrë parasysh situatën të cilën gjendemi, jemi dakorduar njëzëri anëtarët e komisionit që të shqyrtojmë vetëm disa prej amendamenteve që kemi llogaritur se mund të jenë esenciale, në mënyrë që të kalojë buxheti. Kurse pjesa tjetër është lënë që të bëhet në rishikim dhe të përcaktohet sipas prioriteteve që mund të jenë në rishikim.

Pra, për të evituar një situatë ku shqyrtimi i 150 amendamenteve na merr kohë më shumë se tre ditë pune vetëm si komision, e pastaj edhe shqyrtimi i po të njëjtave merr kohë edhe në seancë, e të evitohet situata ku aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese mund të publikohet dhe vendi të shkojë në zgjedhje pa një buxhet të miratuar, ashtu siç edhe e kam shprehur brengën ditën e djeshme, jemi pajtuar si komision që t'i rekomandojmë Kuvendit që të procedohet pa asnjë ndërhyrje tjetër, pra vetëm me amendamentet që kanë marrë mbështetjen e komisionit. Përndryshe, në momentin që hapet dera për të shqyrtuar amendamentet një nga një, shkaktohet problem, kaos, mund të zgjatet seanca e mund të përfundojmë pa një buxhet të miratuar. Faleminderit!

KRYETARJA: Në emër të grupeve parlamentare, në emër të Vetëvendosjes a e dëshiron dikush fjalën? Zoti Liburn Aliu.

LIBURN ALIU: Si grup parlamentar në ndërkohë i kemi shqyrtuar edhe amendamentet dhe është një analizë e përgjithshme, një kalkulim shumë i thjeshtë që këto 124 amendamente, shuma totale në euro është 353 milionë e 560 mijë e 900 euro. Është shumë jashtëzakonisht e madhe, nëse këto amendamente tash të gjitha do të mund të kalonin.

Duhet ta kemi parasysh që do të kemi zgjedhje së shpejti. Pra, jemi në një gjendje parafushate dhe amendamentet shpeshherë janë të ndikuara nga ideja e fushatës.

Por, meqenëse do të jemi në një situatë të tillë dhe do të kemi qeveri tjetër prej kësaj që është sot, pas pak muajsh, atëherë duhet ta kemi parasysh që do mund të bëhet edhe rishikimi i buxhetit që në muajt e parë të qeverisë së ardhshme. Pra, që nga muaji mars e prill eventualisht do të mund të kemi mundësi të rishikimit të buxhetit.

Prandaj, ne si Grup Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje do ta votojmë këtë buxhet, me këto amendamentet e aprovuara nga komisioni. Pra, në komision është diskutuar dhe janë aprovuar, me sa kam mundur të kuptoj, janë pajtuar të gjithë përfaqësuesit e subjekteve politike që të votohet me këto pesë amendamente.

Pra, pa këto 124, të cilat kanë ndikim prej 353 milionë eurosh. Pra, nuk po mund të them që në mesin e atyre amendamenteve mbase janë të arsyeshme shumë prej tyre, por veç për faktin që janë 124 dhe është totali 353 milionë euro, na sjell në një situatë të pazakontë dhe ajo çka mund të themi është që rishikimi i buxhetit mund të fillojë që nga muaji mars, menjëherë pasi të formohet qeveria e re.

KRYETARJA: Faleminderit! Arben Gashi e ka fjalën, grupi i LDK-së.

ARBEN GASHI: Faleminderit, e nderuar kryetare!

Meqenëse Kuvendi i Republikës në seancën e ditës së djeshme ka ratifikuar një marrëveshje ndërkombëtare, vlera e së cilës është 10 milionë euro, kjo marrëveshje nuk është reflektuar në buxhet dhe kërkohet që është si rezultat i ratifikimit të Marrëveshjes Financiare me Bankën Evropiane për Rindërtim e Zhvillim, financimi i infrastrukturës vitale, duhet të shtohet një amendament i ri në projektligj dhe të thuhet: “Në nenin 3 të përkufizimet të plotësohet dhe të ndryshohet si në vijim 1.46 kredi për mbështetje buxhetore, të hyrat në Fondin e Kosovës nga transferi i fondeve nga qeveritë apo institucionet e tjera financiare ndërkombëtare për mbulimin e shpenzimeve buxhetore”.

Neni 2, pas nenit 10, shtohet dispozita ligjore si në vijim: Neni 10a shuma deri në 10 milionë euro dedikuar për rimbursimin e shpenzimeve në kuadër të masës katër të pakos emergjente fiskale nga kredia e likuiditetit të urgjencës, si infrastrukturës vitale mes Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim e Zhvillim, e nënshkruar më datë 17. 8. 2020 disbursohet në vitin fiskal 2021, pas ratifikimit në formën e mbështetjes direkte buxhetore.

Pjesa e mbetur e vlerës së kësaj kredie disbursohet sipas planifikimeve buxhetore në formë të nënhuazimit. Pra, ky është një amendament, i cili duhet të reflektohet në Ligjin e buxhetit, në mënyrë që të reflektohet marrëveshja, të cilën ne e kemi ratifikuar dje si Kuvend.

Unë për procedurë po e dorëzoj në formë të shkruar te ju, zonja kryetare, që ta kenë parasysh administrata në mënyrë të saktë se çka po kërkohet. Faleminderit!

KRYETARJA: Ju e dini që tashmë e kemi ndërtuar një praktikë që për amendamentet që propozohen në seancë na duhet shmangie, në mënyrë që ato të lejohen të futen në radhën e amendamenteve për votim. Mirëpo, po i dëgjoj një herë grupet parlamentare dhe pastaj do të kthehemi te propozimi i zotit Gashi, sepse për t'u lejuar ky amendament i ri të futet në listën e amendamenteve, atëherë na duhet shmangie nga procedura.

Nga Grupi i PDK-së, fjalën e ka zoti Hamza, po supozoj. Urdhëroni!

BEDRI HAMZA: Faleminderit, kryetare!

Ne e dimë që e kemi një vendim të Gjykatës Kushtetuese, e dimë që vendi për disa ditë do të shkojë në zgjedhje, është situatë shumë delikate, nëse vendi shkon në zgjedhje pa buxhet, ka dallim nga herët të kaluara kur zgjedhjet janë mbajtur në muajt tetor a nëntor dhe ka pasur mundësi që të konstituohet Kuvendi, të zgjidhet Qeveria dhe të procedohet më buxhet. Kësaj radhe zgjedhjet ndodhin në kohën kur është më së vështiri që në këtë periudhë të organizohen zgjedhjet, të konstituohet Kuvendit dhe të zgjidhet Qeveria e të procedohet me buxhet.

Me qëllim që vendi mos të përballet me bllokadë, me mungesë të pagave, pensioneve dhe pagesave të tjera, ne si Parti Demokratike edhe në leximin e parë e kemi përkrahur aprovimin e buxhetit. Gjatë punës në komisione të gjithë anëtarët e komisionit jemi pajtuar që një numër i amendamenteve që kanë qenë më së të domosdoshme, të cilat u përmendën më herët, e kanë pasur mbështetjen e gjithë anëtarëve të Komisionit për Buxhet dhe Financa pa dallime politike.

Këtu e shohim një numër të madh të amendamenteve, me vlera shumë të mëdha, nëse hymë në strukturën e amendamenteve, realisht është bukur vështirë të dilet kundër këtyre propozimeve, kundër këtyre amendamenteve, janë të nevojshme, shumë prej tyre janë të domosdoshme dhe të drejta, mirëpo është pothuajse e pamundur që tash në këtë kohë të akomodohen brendapërbrenda buxhetit dhe të votohet buxheti në tërësi.

Prandaj, si komision, po edhe si grup parlamentar jemi të interesuar që vendi ta ketë një buxhet, përkundër defekteve që i ka buxheti, të cilin e kemi para vetes, me qëllim që të krijohet mundësia që të kryhen pagesat e pagave, pensioneve dhe të pagesa të tjera dhe bëhet rishikimi i buxhetit, një rishikim i mirëfilltë, shumë më ndryshe, me një strukturë dhe substancë tjetër dhe brenda këtij rishikimi të buxhetit ka mundësi që të akomodohen këto kërkesa që pjesa e madhe e tyre janë të drejta dhe të arsyeshme. Sigurisht se pas votimeve që do të ndodhin të amendamenteve, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike do ta japë votën pro buxhetit.

KRYETARJA: Grupi Parlamentar AAK, zoti Abrashi e ka fjalën.

GAZMEND ABRASHI: Faleminderit, kryetare!

I nderuar Kabinet qeveritar,

E kolegë deputetë,

Media,

Jam i vetëdijshëm për rëndësinë e madhe të votimit të buxhetit dhe në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës fatkeqësisht kam qenë i vetmi sot pranë Komisionit për Buxhet dhe Financa, i cili ka qenë i gatshëm t'i shqyrtojë të gjitha amendamentet, 124 amendamente, të cilët i kanë dorëzuar kolegët e mi.

Përkundër asaj që të gjithë po pajtohem që është një moment kritik edhe një moment imediat që buxheti duhet të votohet, ne kemi shprehur gatishmërinë dhe vazhdojmë të shprehim gatishmërinë që nëse duhet në këtë Parlament edhe dy ditë të qëndrojmë dhe t'i shqyrtojmë secilën amendament nen për nen, gjithnjë me qëllimin më pozitiv që ky buxhet i vitit 2021 të votohet.

Në analizën që e kam bërë, që ka të bëjë me kërkesat e deputetëve, kam parë shumë kërkesa legjitime që ndërliken me komuna të ndryshme që kanë të bëjnë kryesisht me Ministrinë e Arsimit, dhe me kërkesat e akomodimit të shkollave, të cilat mendoj në situatën e kësaj pandemie janë më se të nevojshme, që të kenë një fokus special, mendoj që qasja e deputetëve dhe qëndrimi i Aleancës është që ne jemi të gatshëm që amendament për amendament, nëse duhet, në aspektin kohor edhe të zgjatet më shumë, rrimë pranë atij qëndrimit që do t'i shqyrtojmë secilin ndaras.

Nëse seanca dhe kolegët deputetë mendojnë ndryshe, është qëndrim i Parlamentit të Kosovës, por ne si Aleancë e Ardhmërinë e Kosovës qëndrojmë mbrapa qëndrimin që e kam mbajtur në Komision për Buxhet dhe Financa, edhe në konsultim me kolegët e mi, jemi të gatshëm të ballafaqohem amendament për amendament. Kur e kam parë analizën e amendamenteve, mendoj që është joreale ose nuk është fer t'i privojmë prej të drejtës shumë deputetë për t'i shqyrtuar amendamentet, të cilat për mua janë kruciale, gjersa nuk është punë jona ose e Parlamentit të Kosovës të merren me buxhetet ku do t'i marrim ato mjete, jona është të tregojmë një përkushtim maksimal për nevojat imediate të qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Gjersa unë si deputet i Parlamentit të Kosovës, në emër të Aleancës e kam apostrofuar idenë e njëjtë, të cilën e kam thënë edhe në muajin mars, 100 euro për kokë të banorit. Besoj që ky Parlament do të gjejë forcë e energji t'i adresojë problemet, me të cilat do të ballafaqohen qytetarët e Kosovës në vitin 2021.

Po çfarëdo vendimi që të marrë kjo seancë, gjithmonë me shumicë të votave, ne do ta përkrahim. Faleminderit!

KRYETARJA: Endrit Shala, Grupi Parlamentar Nisma-AKR- 6+.

ENDRIT SHALA: Faleminderit, kryetare!

Në emër të Grupit Parlamentar Nisma- AKR- 6+ ne pajtohemi, ashtu si gati të gjitha grupet parlamentare që të procedojmë ashtu siç është dërguar në këtë Parlament nga ana e Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe të procedojmë që ta votojmë buxhetin, duke i miratuar ato rekomandime apo ato amendamente, të cilat i kanë propozuar deputetët dhe të cilat janë miratuar nga anëtarët e komisionit.

Po njëkohësisht unë kisha kërkuar nga të gjithë deputetët e Republikës së Kosovës, edhe një herë po e përsëris, duke e pasur parasysh situatën në të cilën jemi, ne të gjithë jemi të vetëdijshëm që si deputetë të Parlamentit të Republikës së Kosovës nuk guxojmë ta lëmë ose me veprimet tona, ose me mosmiratim të buxhetit ta bllokojmë vendin, por të procedojmë me miratimin e buxhetit, por njëkohësisht amendamentet që janë propozuar nga deputetët e Grupit Parlamentar Nisma-AKR-6+, në këtë rast po i përmend amendamentin për stafin e ri të çerdhes në komunën e Malishevës, amendamentin për sigurimin e ujit të pijes të qytetarëve të fshatit Bjellushë të komunës së Prizrenit, amendamentin për krijimin e stafit të çerdhes, e ne të gjithë e dimë si deputetë sa ka nevojë për çerdhe dhe për staf për çerdhe në komunat e Republikës së Kosovës, e që është e planifikuar në Kijevë të komunës së Malishevës, amendamentin për projektin e rrugës së Vreshtave që është nevojë për qytetarët e komunës së Malishevës dhe vreshtarëve të asaj pjese dhe njëkohësisht projektin, i cili ka të bëjë me ndërtimin e rrugës për ish-Kabash, e që ky projekt përpos nevojave të qytetarëve të asaj ane, të fshatit Korishë, ka edhe qëllimin për mundësinë e zhvillimit turistik të asaj pjese.

E nderuar kryetare e Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

Ne si grup parlamentar do ta votojmë këtë buxhet dhe njëkohësisht kërkojmë nga të gjithë deputetët e Parlamentit të Republikës së Kosovës që këto amendamentet të propozuara nga Grupi Parlamentar Nisma-AKR të votohen si amendamente të propozuara nga deputetët e Parlamentit të Kosovës. Faleminderit!

KRYETARJA: Nga Lista serbe nuk është askush këtu. Do t'i dëgjoj sipas paraqitjes, mirëpo fillimisht do t'u japim përparësi komisioneve parlamentare dhe pastaj do të kthehem te deputetët. Komisioni Parlamentar për Shëndetësi e ka kërkuar fjalën për një propozim, amendament të ri në seancë.

ALBENA RESHITAJ: Faleminderit, kryetare!

Të nderuar kolegë deputetë,

Kabinet qeveritar,

Duke pasur parasysh dinamikën e fundit dhe problemin me kohën, ne si Komision për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale kemi marrë pak me vonesë një kërkesë për të përkrahur një sëmundje të rëndë tek fëmijët, siç është fibroza cistike, gjegjësisht Ministria e Shëndetësisë nuk

ka pasur mundësi të ndajë buxhet për barnat apo terapinë që u nevojitet 100 pacientëve, 100 fëmijëve me fibrozë cistike, me sëmundje kaq të rëndë.

Ne kërkojmë, po qe se ka mundësi me shmangie, që të procedohet edhe ky propozim-amendament, ose nga Komisioni për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, sepse të gjithë anëtarët e komisionit besoj se janë pro. Nëse jo, atëherë mund ta propozoj edhe unë si deputete. Pra, ka të bëjë me shumën 742 850 mijë euro. Janë disa barna, terapi të nevojshme për pacientët, për 100 fëmijët që vuajnë nga fibroza cistike. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit! Replikë apo diskutim keni kërkuar, veç ta kemi të qartë, për shkak të minutazhës. Ok! Sqarim, zoti Liburn Aliu dhe do të kthehem te ministri i Shëndetësisë pastaj lidhur me amendamentin e propozuar.

LIBURN ALIU: Unë vetëm dua të jap një sqarim. Ne i kemi shqyrtuar këtu 124 amendamente. Në mesin e tyre ka amendamente që kanë arsytetime jashtëzakonisht të mira. Shumë prej tyre, po të veçoheshin veç e veç edhe do të votoheshin, por kur e marrim si tërësi, komplet këtë idenë e amendamenteve 124 dhe pamundësinë që pastaj Qeveria, ose në gjendjen në të cilën do të jemi, që të mos mund të ballafaqohet me këtë situatë, pra të mos harrojmë edhe një herë, bëhet fjalë për 353 milionë euro që duhet dhënë përgjigje, e që nuk ka mundësi t'u jepet. Dhe, nëse hyjmë në këtë lojë e amendamenteve, atëherë krejt këta kanë të drejtë t'i arsyetojnë amendamentet e veta, sepse plot prej këtyre propozimeve janë plotësisht të drejta.

Po frikohem se po hyjmë në një lojë, në të cilën pastaj kur të fillojmë amendament për amendament, s'ka më as buxhet, nuk ka më as situatë serioze që mund të merremi me të, por hyjmë në njëfarë loje që nuk ia dimë fundin.

KRYETARJA: Ministri i Shëndetësisë e ka kërkuar fjalën.

MINISTRI ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryetare!

Unë e kuptoj trajtimin e buxhetit në lexim të dytë dhe ruajtja e parametrave buxhetorë. E kisha pasur një lutje, që këtu ta keni një përjashtim rreth këtij amendamenti të propozuar. Ka të bëjë me përkrahjen për 100 fëmijë apo 100 familje, për të cilët kostoja e mbulimit, që kjo quhet sëmundje e rrallë, është e papërballueshme.

Projekti Hope dhe Ministria e Shëndetësisë e kanë financuar një pjesë, ta quaj kushtimisht, të këtij lloji ilaçi, por pjesa tjetër ka qenë kërkesë në vazhdimësi edhe nga deputetët këtu të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Ajo që po kërkohet për dy barnat shtesë dhe që u arsyetua si propozim i Ministrisë së Shëndetësisë edhe i komisionit, mendoj që duhet t'i tejkalojë edhe parametrat dhe të gjenden mënyrat e financimit të tyre, së paku për vitin e ardhshëm. Ju kisha lutur që ta votoni dhe ta përkrahni!

KRYETARJA: Mirë. Po vazhdojmë me dy propozime të cilat u dhanë... Urdhëro, një sqarim. Zoti Daut Haradinaj e ka kërkuar fjalën.

DAUT HARADINAJ: Faleminderit, kryetare!

E pashë që i kanë bërë dy ose tri përjashtime kur i kanë miratuar në paketë amendamentet, për shembull, rasti për KQZ-në, ishte rasti për vaksinën COVID dhe ishte për disa kërkesa të Kuvendit të Kosovës.

Meqenëse është kështu, kisha kërkuar prej kolegëve të mi deputetë që të miratohen nenet 76, 77, 78, 79, 81, 82, 83, që ndërlidhen me Komunën e Skenderajt, sepse mendoj që u është bërë padrejtësi shumë e madhe në momentin që u janë larguar ato mjete, meqenëse ato projekte janë në vazhdimësi e sipër. Mendoj që përjashtimisht kërkoj mirëkuptimin e kolegëve të mi deputetë dhe publikisht i lus që t'u japin mbështetje këtyre amendamenteve. Në rast se i kemi anashkaluar pesë amendamente, le t'i anashkalojmë edhe pesë të tjera dhe t'i votojmë në paketë. Pastaj, për të tjerat këtu do të jemi, le të vendosë seanca.

KRYETARJA: Faleminderit! Zoti Hekuran Murati e ka kërkuar fjalën. Për këtë çështjen që u ngrit, po supozoj që e keni fjalën.

HEKURAN MURATI: Faleminderit, e nderuar kryetare!

Unë kur fola në emër të komisionit, e thashë dhe e sqarova arsyen pse kemi ardhur deri te ky vendim. Pra, si anëtarë të komisionit, si njerëz të profesionit kemi vendosur që kjo është rruga më e mirë për të ecur përpara dhe kemi gjetur një konsensus. Tash këtu problemi është se po tentohet të bëhet njëfarë fushate politike me gjëra, për të cilat nuk do të duhej të bëhet fushat. Nëse është e nevojshme, unë besoj se është e nevojshme, edhe çështja për amendamentin që u prezantua nga zonja Reshitaj, edhe që u tha nga ministri që qenka e rëndësishme, mund t'i akomodojë brendapërbrenda buxhetit të Ministrisë.

Nëse është e rëndësishme dhe është prioritet, pse nuk e ka sjellë ministri me kohë në Buxhet, por na vjen tash si amendament dhe ministri thotë "është i mirë". Pra, qëndrimi është kështu: në momentin që hapet dera për amendamente, u tha edhe më herët nga kolegë të tjerë, që secili amendament aty nuk është se është i kotë, domethënë e ka një arsyetim prapa. Secili amendament, nëse e marrim veç e veç, e ka një arsyeshmëri, por problemi qëndron në faktin që jemi në një situatë specifike, jemi në një situatë para zgjedhjeve, e ndoshta mund të përfundojmë pa buxhet. Këtë hall e kisha dje, këtë hall e kam edhe sot.

Për neve është me rëndësi që të gjitha amendamentet dhe i kisha lutur edhe shefat e grupeve parlamentare, që t'i lusin deputetët e grupeve të tyre t'i tërheqin amendamentet dhe të mos mundohen të bëjnë fushatë, sepse dje u tha që duhet të votohet Ligji i Buxhetit për të siguruar

stabilitet financiar dhe për të evituar një krizë. Sot me këto sjellje të papërgjegjshme po dëshmohet, se nuk paska qenë halli i evitimit të krizës, por është halli i fushatës.

Pra, le të mos bëjmë fushatë, le ta sigurojmë një konsensus dhe të shkojmë tutje duke votuar rekomandimet që i ka sjellë Komisioni për Buxhet dhe Transfere. Përndryshe, ne nuk jemi të sigurt se mund të mbështesim çfarëdo ndryshimi, përkundër faktit se secili amendament veç e veç që është aty e ka arsyeshmërinë e vet dhe mund të jetë i rëndësishëm. Por, atë është dashur Qeveria ta bëjë, ta prioritizojë me kohë. Nëse s'e ka bërë Qeveria si duhet, pra këtë që e kemi përpara, do të duhet ta bëjë Qeveria e ardhshme në rishikim dhe kjo do të bëhet.

Pra, secili prioritet, secila nevojë, secila domosdoshmëri, që ekziston do të trajtohet në rishikim të buxhetit pas tre muajsh. Edhe një herë ju lus, që të mos bëjmë shou, të mos bëjmë fushatë, ta kemi një konsensus, po kërkoj nga të gjithë ju që t'u qëndroni prapa fjalëve tuaja që i thatë dje, që keni interesin e qytetarëve parasysh dhe se nuk doni ta lini vendin të shkojë në një krizë financiare. Urdhëroni, dëshmojeni këtë sot!

KRYETARJA: Vetëm një sqarim procedural, fillimisht. Në qoftë se shkohet përpara me propozimin që këto 120 amendamente që nuk kanë përkrahje të komisionit të shkojnë në pako, atëherë ne do të duhet edhe për atë çështje të bëjmë shmangie nga Rregullorja, sepse siç e dini, Rregullorja kërkon që secili amendament të shqyrtohet dhe të votohet veç e veç. Pra, do të jetë përfundimisht vendim i grupeve parlamentare, në qoftë se dëshironi ato 120 amendamente t'i shqyrtojë bashkërisht apo një nga një. E njëjta do të vlejë pastaj edhe për dy amendamentet e reja të propozuara sot në seancë, sepse ato nuk i ka trajtuar komisioni. Pra, nuk hyjnë te amendamentet me përkrahje të Komisionit FunkSIONAL.

Rrjedhimisht, në qoftë se vendoset që 120 amendamente të shkojnë në pako dhe edhe këto dy të reja hyjnë në shqyrtim, atëherë të gjitha 122 do të shqyrtohen në pako, meqenëse këto dy të reja sot, përveç në qoftë se komisioni deklarohet ndryshe dhe lejon që të futen te kjo 12-shja e parë, atëherë nuk do të mund të veprojmë ndryshe. Po flas në aspektin procedural.

Unë pajtohem që ka këtu shumë amendamente që meritojnë përkrahjen, si ato që u përmendën për Skenderajn, shumica kanë të bëjnë me ujin e pijshëm, gjënë më të rëndësishme që na duhet sidomos në kohën e pandemisë. Por, ne do t'ju dëgjojmë juve lidhur me qëndrimet që i keni sa i përket trajtimit të amendamenteve, në pako apo veç e veç. Urdhëroni dhe deklarohuni si grupe parlamentare.

PDK-ja ishte e qartë se dëshirojnë të trajtohen në pako ato që nuk e kanë përkrahjen e komisionit, në fillim. Do t'ua jap sërish fjalën. Njësoj edhe zoti Murati. Do t'ua kërkoj edhe grupeve të tjera që të deklarohen rreth kësaj çështjeje, në mënyrë që ta dimë si të procedojmë. Urdhëro, ministër!

MINISTRI ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryetare!

E para, unë dua ta përsëris. As nuk dua të interferoj në buxhet, as të prish balancën, as punën e komisioneve në fjalë. Kërkesa jonë ka qenë kërkesë në afate. Unë nuk mund të garantoj për Zyrën për parashtresa apo rrugët se si barten letrat apo shkresat. E fundit që e kemi shpjeguar financimin e kësaj sëmundjeje të rrallë, ka qenë drejtuar pyetja e fundit, nëse nuk gaboje, deputeti Enver dhe e kemi sqaruar në mënyrë specifike se si është duke u financuar sëmundja apo fëmijët me fibrozë cistike.

Problemi është se kjo është ndërprerë nga një partner, i cili ndihmon Ministrinë e Shëndetësisë dhe pacientët në Kosovë. Ne kemi filluar një procedurë brenda Ministrisë së Shëndetësisë, por për ta plotësuar për tërë vitin është kjo kosto që po kërkohet. Domethënë, ne jemi në procedurë për fillimvitin të sigurimit të kësaj kostoje dhe mënyrës së financimit, por është e domosdoshme që ata prind dhe ata familjarë të sigurohen për gjithë vitin. Kaq po dëshirojmë, nuk ka asnjë gjykim apo ndonjë paragjykim tjetër, qoftë edhe atë që e parashtroi kryetarja e Komisionit për Shëndetësi.

KRYETARJA: Një herë në emër të grupeve parlamentare, ju lus të sqaroni lidhur me procedurat që po propozoni të ndiqen për shqyrtimin e amendamenteve pa përkrahje të komisionit. Zoti Liburn Aliu, pastaj zoti Gashi e ka fjalën.

LIBURN ALIU: Para kësaj kërkoj nga zonja Hykmete Bajrami të na sqarojë. Herën e kaluar kur është votuar buxheti, ka pasur shumë amendamente të cilat janë tërhequr dhe është gjetur zgjidhje që brenda buxhetit të rregullohet kjo çështje. A mund ta rregullojë çështjen e kërkesës në lidhje me amendamentin për sëmundjen e fibrozës cistike? Nëse diçka e tillë mund të rregullohet, shumë lehtë mund të kalojmë në pako dhe nuk kemi pse e komplikojmë. Pastaj, me rishikim pas tre muajsh kjo çështje mund të zgjidhet.

KRYETARJA: Sa i përket trajtimit të amendamenteve në pako? Urdhëro, zoti Aliu.

LIBURN ALIU: Qëndrimi ynë është që ne i votojmë në pako. Pra, në pako për dhe në pako kundër.

KRYETARJA: Zoti Gashi e ka fjalën.

ARBEN GASHI: Faleminderit! Unë i kam dy çështje. Sa i përket amendamentit që e propozova, është një amendament që fut para në buxhet, jo që nxjerr para prej buxhetit. Pra, është amendament që fut para në buxhet nga një marrëveshje ndërkombëtare, e cila është ratifikuar dje.

Sa i përket çështjes së votimit në pako, për të refuzuar amendamentet individuale, unë kam dyshimet e mija se a kemi të drejtë ta bëjmë këtë punë. A mund t'ia mohojmë të drejtën një

deputeti që në seancë të propozojë amendamentin e tij dhe ta arsyetojë amendamentin e tij apo të saj. Pra, kam dyshimet e mia për ligjshmërinë e këtij veprimi nga ana e Kuvendit. Pra, do të ishte mirë që ta kishim një këshillë juridike për këtë veprim. Faleminderit!

KRYETARJA: Sipas nenit 58.3 të Rregullores së Kuvendit është përcaktuar, siç e thashë edhe më herët, që amendamentet shqyrtohen dhe votohen një nga një. Prandaj, për ta ndryshuar këtë rregull mund të bëhet vetëm me shmangie nga Rregullorja, kur propozimi është i qartë. Ta zëmë, ka ndodhur shumë herë në të kaluarën, kur ato janë vendosur të gjitha në votim në pako. Prandaj, është propozim, por në fund vendos seanca për diçka të tillë. Urdhëro, po supozoj replikë.

ARBEN GASHI: Më shumë sqarim, jo replikë. Ideja e votimit në grup ka qenë gjithmonë votim afirmativ. Pra, kur ka pasur pajtim nga të gjithë që të aprovohet diçka. Por, që të ketë një pajtim nga shumica që një pakice t'i mohohet një e drejtë e prezantimit në Kuvend, kam frikë se po shkelim një të drejtë elementare të deputetit që t'i propozojë Kuvendit dhe ta arsyetojë një amendament.

Pra, kam frikë se po hyjmë në një terren, në të cilin nuk kemi hyrë asnjëherë. Amendamentet personale nuk i kemi refuzuar asnjëherë në grup. Kemi refuzuar një nga një, por në grup nuk më kujtohet se kemi bërë një veprim të tillë. Faleminderit!

KRYETARJA: Po, e kuptoj drejt, mirëpo unë nuk paragjykova a do të votohen pro apo kundër. Thjesht, pyetja ishte a pranoni t'i votoni në pako? Po kthehem edhe një herë. Nuk po shoh se grupet e tjera e kanë kërkuar fjalën. Vetëm t'i dëgjoj grupet të gjitha.

Lidhur me pyetjen që e bëra rreth propozimit që u dha për votim në pako, pra LDK-ja i ka dyshimet e veta rreth asaj se a lejohet apo jo një gjë e tillë. Urdhëro, zoti Abrashi.

GAZMEND ABRASHI: Faleminderit, kryetare!

Të nderuar kolegë deputetë,

Aleanca vazhdon të luajë rolin e vet konstruktiv, ka interes dhe ka pasur interes që ky projektligj, gjegjësisht Buxheti për vitin 2021 të kalojë. Këtë qëndrim e ka pasur edhe dje, e kemi pasur edhe sot, por duke mos e njohur Rregulloren saktë se a kemi të drejtë me shmangie ta evitojmë ose të procedojmë me këtë lloj të votimit, ne qëndrojmë prapa mendimit që e dhamë si grup parlamentar që të merremi me amendamente një për një, me qëllim që t'u dalim karshi kërkesave të kolegëve deputetë dhe qytetarëve të Kosovës. Faleminderit!

KRYETARJA: Nisma, e dëshironi fjalën? Jo! Më falni, se ju paskam kaluar. Zoti Hamza e ka fjalën.

BEDRI HAMZA: Faleminderit, zonja kryetare!

Unë prita pak më ndryshe. Ata që kanë qenë përgjegjës ta bëjnë buxhetin në kohë dhe pa vonesë, sot po shihet se janë duke kontribuar në komplikimin e situatës. Përgjegjësinë për ta bërë buxhetin e të mos vijmë në këtë situatë e kanë pasur partitë që kanë qeverisur. E pashë një vullnet të partive që kanë qenë në opozitë për të ecur me këtë proces. Prandaj, është e drejtë e tyre të kërkojnë që të shkohet amendament për amendament, e ku i nxjerr kjo situatë, më së miri e dinë ata.

KRYETARJA: Jemi duke diskutuar vetëm për procedurë, për momentin, nuk kemi hyrë te diskutimet. Në qoftë se dikush e dëshiron fjalën vetëm për procedurë, urdhëroni! Edhe një herë Hekuran Murati, pastaj po kthehem te LDK-ja.

HEKURAN MURATI: Sa i përket procedurës dhe asaj që u dha se po kufizohet e drejta e deputetit, ne të njëjtën e kemi bërë dje kur kemi kufizuar të drejtën e deputetëve për të dorëzuar amendamente që i kanë dy javë kohë. Domethënë, e kemi kufizuar, u kemi thënë deri sot në ora 10:00. Kjo ka ndodhur. Tash, të njëjtën gjë po e bëjmë edhe këtu. Kështu që konsideroj se nuk mund të thuhet se po kufizohet apo po mohohet ndonjë e drejtë. Deputetët kanë dorëzuar amendamentet dhe po vendos seanca. Nëse seanca vendos që ato në pako të mos kalojnë, pra nuk mund të thuash se po i mohohet dikujt e drejta, njësoj sikurse amendamenti individual që nuk kalon, nuk mund të thuhet se iu mohua e drejta një deputeti që të kalojë ai amendament, sepse seanca ka vendosur ashtu.

Por, me këto deklaramë, me sa po shoh, domethënë këtu më shumë ka interes për të bërë fushatë, sesa për ta kaluar buxhetin. Domethënë, me këto fjalime, me këto qëndrime, nuk po shoh se ka vullnet për të kaluar buxhetin. Pra, po vërtetohet ajo që u tha dje. Nuk është interesi këtu për të kaluar buxhet, këtu interesi është për të bërë fushatë, jo për të kaluar buxhet. Faleminderit!

KRYETARJA: Po, po, ka shumë kërkesa, vetëm ju lus, sipas radhës. Po, tash kthehem te ju. Endrit Shala e ka fjalën.

ENDRIT SHALA: Faleminderit, kryetare!

Duke i dëgjuar të gjithë përfaqësuesit e grupeve parlamentare dhe dëshirën e tyre që këtë buxhet, duke pasur parasysh nevojën që e ka qytetari i Republikës së Kosovës që të miratohet ky buxhet, që ta prolongojnë miratimin e këtij buxheti, atëherë duke u bazuar në Kushtetutë, Qeveria e Republikës së Kosovës është e obliguar t'i sjellë Parlamentit të Republikës së Kosovës buxhetin për miratim, por njëkohësisht me Kushtetutë secili deputet i Parlamentit të Republikës së Kosovës ka të drejtë të bëjë amendamente dhe ne si grup parlamentar mendojmë se secili amendament që është i propozuar nga deputetët e Republikës së Kosovës e që përfaqëson nevojat e qytetarëve të Republikës së Kosovës, se deputetët i përfaqësojnë nevojat e qytetarëve të tyre

dhe të votuesve të tyre, atëherë secili amendament të diskutohet veç e veç dhe të miratohet, ose të mos miratohet.

KRYETARJA: Në rregull! Zoti ministër, urdhëroni! Po do ta tërheqë amendamentin...

MINISTRI ARMEND ZEMAJ: Unë e kuptoj këtë natyrën e deputetëve dhe të përfaqësuesve të grupeve, sidomos në pjesën opozitare për të ngritur apo për t'u munduar për të pasqyruar diçka tjetër nga ajo që po kërkohet me sinqeritet. Vetëm po e përsëris, për tre muajt e parë të vitit, edhe në komunikimin që jam me projektin Hope, mund të vazhdohet, por për të mos pasur dilema dhe për të mos krijuar mungesë përkrahjeje për ata prindër, unë tregova që për tre muaj Ministria e Shëndetësisë e ka të siguruar.

Nëse ju mendoni që mund ta lini këtë në vullnetin dhe në procedurat e një buxheti tjetër, atëherë ne edhe mund të tërhiqemi nga ky propozim-amendament. Nëse ju besoni se kjo vazhdon pas tre muajve dhe u sigurohet ajo përkrahje financiare për ata 100 prindër, atëherë mendoj që le të mbetet në moralin tuaj dhe në votën ruaj, që është vullnet dhe besim i çdonjërit nga ju.

KRYETARJA: Zonja Reshitaj, meqenëse ju e propozuat, formalisht a mund të na tregoni cili është qëndrimi përfundimtar? A dëshironi ta fus në votim amendamentin? Albena Reshitaj e ka fjalën.

ALBENA RESHITAJ: Faleminderit, kryetare!

Fillimisht, më vjen shumë keq që ne detyrohemi të vijmë si deputetë dhe ta shtyjmë në buxhet për një kategori kaq të ndjeshme të vendit tonë, siç janë fëmijët me fibrozë cistike.

Është turp i madh për ne dhe për shëndetësinë tonë të lëmë në buxhet apo në propozim-amendamente një çështje kaq të ndjeshme, e para. Kjo është dashur të rregullohet shumë më herët. As të mos ketë nevojë ne si deputetë apo komision të merremi me këtë çështje.

E dyta, i lus të gjithë deputetët që janë në sallë që të reflektojnë dhe të na përkrahin në këtë çështje. Faleminderit!

KRYETARJA: Po procedojmë me deputetët sipas paraqitjes. Besa Gaxherri e ka fjalën.

BESA GAXHERRI: Faleminderit, kryetare!

Të nderuar kolegë deputetë,

Gjithmonë edhe në afatet e rregullta kur është diskutuar buxheti ka pasur kërkesë për mirëkuptim. Kësaj radhe ju përgëzoj, dy partitë politike opozitare, që po e shoh se keni arritur pajtueshmërinë për ta votuar buxhetin, duke pasur parasysh relevancën dhe situatën, në të cilën jemi. Megjithatë, unë i shikova me vëmendje amendamentet. Ato amendamente të cilat është

pajtuar Komisioni, i ka dhënë pëlqimin, të jemi të sigurtë, janë kërkesat e partive opozitare që unë pajtohem. Unë pajtohem, por nuk pajtohem të gjitha këto amendamentet i keni futur në një thes. Në aspektin profesional dhe teknik, ju lutem, çdo mandat ka pasur amendamente që nuk i ka plotësuar kushtet dhe ai automatikisht refuzohet.

Një gjë e tillë është dashur të bëhet edhe kësaj radhe. Së paku 50 për qind mendoj unë se amendamentet s'ishin futur fare këtu. Ndërsa amendamente të caktuara, me relevancë tepër të madhe, që nuk kërkojnë buxhet shtesë, siç është amendamenti im konkretisht, është e padrejtë që mos të futet në buxhet. As nuk ka buxhet shtesë, ka vetëm një kod për t'iu dhënë dhe të shkojë tutje. Kjo është për mua e papajtueshme, dikush ka arritur të fusë amendamentet, ndërsa dikujt nuk i jepet mundësia. Faleminderit!

KRYESUESJA: Janë edhe dy deputetë të lajmëruar për fjalë. Por kijeni parasysh se duhet të hedhim në votim d.m.th. sipas nenit 58, me përjashtim nëse keni diçka për procedurë. Përndryshe, po vazhdojmë sipas propozimit, neni 58 pika 3 e Rregullores së Kuvendit është përcaktuar se amendamentet shqyrtohen dhe votohen një nga një sipas radhitjes së paraqitur, krahas tekstit të projektligjit. Ndërsa, në paragrafin 4 të këtij neni, është përcaktuar se kur janë të propozuara dy amendamente për të njëjtin nen të Projektligjit që përjashtojnë njëri-tjetrin, amendamenti i cili merr numrin më të madh të votave konsiderohet i miratuar.

Përpara se të vazhdoj me këtë, duhet të votohet me dy të tretat propozimi i kryetarit të Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe mandej nëse i merr dy të tretat vazhdojmë me pako, përndryshe vazhdojmë me amendamentet një nga një.

Për procedurë Bekim Haxhiu. Hajde të shohim çfarë procedurash.

BEKIM HAXHIU: Po kush je ti që ta shohësh, po kjo është e drejtë e barabartë, jemi deputetë këtu unë dhe ti dhe 119 deputetë.

KRYESUESJA: Zoti Haxhiu, për procedurë e keni fjalën.

BEKIM HAXHIU: Bash për procedurë është nënkryetare. Këtu jemi deputetë të barabartë të gjithë. Është mandati im i katërt këtu dhe kam miratuar disa buxhete në të kaluarën. Kjo çka po propozohet sot nga Komisioni për Buxhet dhe Transfere është supremacia e Komisionit mbi seancën. Prandaj, nuk lejohet. Në çdo propozim-amendament, deputetët e kanë të drejtën të arsyetojnë dhe të bindin seancën për arsyeshmërinë e atij propozimi. Nuk mundet Komisioni i cili në mungesë të kohës ka vendosur që t'i refuzojë në pako propozimet e deputetëve. Unë po ju them vetëm një fakt. Një nga amendamentet që unë kam propozuar është vetëm ndryshimi i emrit të projektit. Dhe çka ka ndikim ajo që sot të refuzohet në pako. Ku e ka këtë të drejtë Komisioni për Buxhet dhe Transfere ta marrë supremacinë mbi seancën e Kuvendit. Seanca

vendos për çdo propozim, prandaj nuk jam që këto të votohen në pako, por të shqyrtohen një nga një. Atë që e tha deputeti Haradinaj, janë disa prej propozimeve, të cilat...

KRYESUESJA: Faleminderit, z. Haxhiu. Atëherë pra po pajtohem me ju. E hedhim në votim dhe keni të drejtën të votoni kundër. Përndryshe, plot prej çështjeve, meqenëse në Komisionin për Buxhet dhe Transfere secili grup parlamentar i ka përfaqësuesit e vet, përfshirë shefin e grupit tuaj parlamentar, këto gjëra duhet t'i dakordoni në grup. Është lajmëruar tash, meqenëse e morën fjalën edhe z. Haxhiu, deputeti Fatmir Rexhepi e ka kërkuar fjalën dhe pastaj Arben Gashi.

FATMIR REXHEPI: Faleminderit, nënkryetare!

Jam lajmëruar që herët. Meqenëse e hapët një lloj debati, qoftë për procedurë, qoftë për vlerësimin që është bërë sot nga Komisioni për Buxhet. Prandaj, unë sa i përket procedurës, nuk kam çka ju mësoj juve, jemi kolegë, i dini krejt, por e ndjeva për borxh këtu ta them që Komisioni për Buxhet ashtu qysh tha kryetari i Komisionit dhe kolegët e tjerë, sot e ka bërë një shumë të mirë, e cila këtu po deformohet dhe nuk po thuhet drejt nga disa të tjerë, jo nga Komisioni, por po keqinterpretohet. Përndryshe, jemi bazuar nga fakti se dje është thirrur seancë e jashtëzakonshme. Është thirrur për ta aprovuar Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021.

Dhe në seancë të jashtëzakonshme ne kemi marrë një detyrë si Komision për Buxhet po ashtu të punojmë në rrethana të jashtëzakonshme. I kemi pasur parasysh një marrëveshje në të cilën kemi vlerësuar se për të kaluar ky buxhet, për të mos e sabotuar, për t'iu përmbajtur atyre premtimeve dje që kemi diskutuar këtu, për ata mijëra e mijëra njerëz që nesër presin paga e gjithçka tjetër pra në funksionim të institucioneve, ne e kemi vetëm një alternativë. Askujt s'po shikojmë t'ia bëjmë me hile. E kemi pra të vetmen mundësinë që t'i votojmë propozimet që i ka dhënë Komisioni për Buxhet, përndryshe do ta krijojmë një buxhet që nuk ka mundësi askush ta implementojë, dhe të mos e mashtrojmë askënd. 300 milionë i kemi mangut, pale edhe 300 të tjera sa bëhen vitin e ardhshëm. Nëse ia duam të mirën, nëse duam ta kalojmë, lutja e Komisionit në këtë kuptim ka shkuar. Edhe e kolegëve, edhe e jona, prandaj mos t'i japim kah tjetër, pos ta aprovojmë kështu si është. Ju faleminderit!

KRYESUESJA: Ju faleminderit shumë z. Rexhepi. Fjalën e ka Arben Gashi.

ARBEN GASHI: Faleminderit!

Tash këtu kanë mbetur dy rrugë, ose futja në votim, që ka dyshime për bazën ligjore, ose tërheqja e amendamenteve. Rrugë tjetër s'ka. Mendoj se rrugë më e arsyeshme është tërheqja e amendamenteve në mënyrë grupore, dhe nëse janë të pajtuar edhe grupet e tjera parlamentare, ne mund t'i tërheqim amendamentet dhe pastaj shkojmë vetëm në amendamentet që e kanë përkrashjen e Komisionit, i votojmë ato dhe përfundojmë. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Tani ky është një propozim i ri, por për t'u miratuar ky propozim nevojitet vullneti i deputetëve që kanë më shumë se 120 amendamente.

Atëherë, e vendos në votim propozimin e Komisionit për Buxhet dhe Transfere. E kemi parasysh, votojmë për propozimin që e bëri kryetari i Komisionit.

Hekuran Murati e ka fjalën edhe një herë për sqarim. Përndryshe, ndërkohë edhe një herë, për propozimin e z. Arben Gashit për tërheqje të amendamenteve. Kjo është në vullnetin e deputetëve, por nuk mund të marrë vendim seanca që secili deputet a ka vullnet apo jo, individualisht i tërheq. Nëse duan, mund t'i japim kohën e nevojshme për t'i tërhequr, po s'po duket që ekziston ky vullnet.

HEKURAN MURATI: Pra, propozimi ishte që i kemi 12 amendamente, përfshirë edhe ato teknike që janë bërë për t'i përshtatur tabelat e buxhetit, të cilat janë me mbështetje të Komisionit. Janë 138 amendamente të tjera të mbetura, që janë pa mbështetjen e Komisionit. Propozimi është që të shmanget Rregullorja, ashtu që amendamentet me mbështetje të Komisionit të votohen në pako, si dhe amendamentet pa mbështetje të Komisionit të votohen në pako. Pra, që të dy kategoritë të votohen në pako. Ky është propozimi.

KRYESUESJA: Faleminderit për sqarim edhe një herë z. Murati! Atëherë e hedhim në votim këtë propozim të Komisionit. E keni parasysh se për shmangie nga Rregullorja, duhet të jenë dy të tretat e votave të deputetëve të pranishëm dhe që marrin pjesë në votim.

Kush është për propozimin e Komisionit për Buxhet dhe Transfere?

Kush është kundër? A ka abstenime?

Atëherë konstatoj që në votim kanë marrë pjesë 83 deputetë. Me 66 vota për dhe 17 kundër miratohet propozimi i Komisionit për Buxhet dhe Transfere.

Tani vazhdojmë me votim përsëri për propozimin e kryetares së Komisionit, znj. Albena Reshitaj.

Vazhdojmë me të njëjtën procedurë. Pra, dy të tretat.

Kush është për?

Pra, votojmë që amendamenti të trajtohet në pako bashkë me këto amendamentet e tjera. Propozimi që e bëri znj. Albena Reshitaj në kuadër të Komisionit. Po! I njëjti pastaj do të votohet në grup me këto 128 amendamente të tjera.

Kush është për? A është dikush kundër? A ka abstenime? Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr kryetarja e Kuvendit, znj. Vjosa Osmani.)

KRYETARJA: Zëvendëskryeministri Tahiri e ka fjalën.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI BESNIK TAHIRI: Faleminderit, kryetare!

Sa i përket amendamentit që e ngriti kryetarja e Komisionit për Shëndetësi dhe ministri, ajo çka u diskutua edhe me ministren, ne do të marrim një vendim që çdo muaj, për tre muajt rresht sa të kemi, të marrim vendim brenda Qeverisë t'i përmbylim, respektivisht ta përmbushim buxhetin për këtë sëmundje. Faleminderit!

KRYETARJA: Atëherë, pas kësaj deklaratë të zëvendëskryeministrit, e lus edhe një herë kryetaren e Komisionit për Shëndetësi, pas kësaj deklaratë të zëvendëskryeministrit që Qeveria e merr përsipër që me një vendim t'i mbulojë shpenzimet. A e dëshironi fjalën sërish? Urdhëroni znj. Albena Reshitaj.

ALBENA RESHITAJ: Atëherë, faleminderit prej zëvendëskryeministrit!

Ministrisë, Qeverisë, që e kanë marrë përgjegjësinë. Kjo është dashur, e thashë edhe më herët, që nga fillimi d.m.th. trajtohet vetë nga Ekzekutivi dhe mos të kishte nevojë të vinte në Parlament, edhe të varet faktikisht për buxhet. Në buxhet do të duhej të bëhej ndarja buxhetore vetë nga Ministria.

KRYETARJA: Atëherë, çfarë ndodh me amendamentin, në qoftë se mund të deklaroheni? A e mbani? Meqenëse Qeveria u deklarua që me vendim do ta ndajë këtë pjesë. Ashtu u deklarua zëvendëskryeministri. Urdhëro znj. Reshitaj edhe një herë.

ALBENA RESHITAJ: Në rregull! Me rëndësi për ne është që këto 100 familje apo 150 familje sa janë në Kosovë, ta marrin trajtimin 100 fëmijët me fibrozë cistike të marrin trajtimin e duhur në kohë të duhur. Ju faleminderit!

KRYETARJA: Në rregull! Atëherë po vazhdojmë me amendamentet.

Po fillojmë me amendamentin e parë, i cili është propozuar. A dëshironi të gjitha ato që janë me përkrahjen e Komisionit Funkcional që të shkojnë në pako? Në rregull.

Amendamentet 1 që është në pjesën tekstuale, pastaj amendamentet 2 deri në 10 dhe amendamenti 12, në pjesën tabelore të Projektligjit janë propozuar nga Komisioni Funkcional. Edhe 11? Sepse këtu nuk po shkruan. Atëherë, po e përmirësoj: amendamentet 1 deri 12 e kanë përkrahjen e Komisionit Funkcional dhe do të votohen në pako.

Lidhur me këto amendamente të Komisionit, e dëshironi fjalën? Vetëm në qoftë se ka në emër të Grupit diçka. Z. Gashi thotë që jo. Do të kthehem pastaj te pjesa tjetër, te diskutimet, sepse në qoftë se i hapim diskutimet, atëherë e kam të pamundur t'i ndalë dhe duhet lejuar secilin deputetë.

Po i vendos në votim në pako amendamentet 1 deri 12 me përkrahjen e Komisionit Funkcional.

Kush është për? A ka kundër? Nuk ka! A ka abstenime? Nuk ka! Faleminderit!

Urdhëro! Besa Gaxherri e ka fjalën.

BESA GAXHERRI: Kryetare, kërkoj falje!

Unë më parë e mora fjalën për procedurë. Nuk isha krejt e sigurt që e kalojmë kështu. Është një amendament të cilin është shembull që vërtet Komisioni nuk i ka shikuar hiç asnjë amendament. Këtë amendament e keni votuar në rishikim të gjithë deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës, për të cilin ju kam falënderuar shumë. Nuk desha fare ta përmend, për mos të dukem se po bëjmë politikë me amendamente dhe shpresova që po i vjen radha po kalon kështu. Tash, po ju lus, fjala është për sigurimet shëndetësore të viktimave seksuale të luftës. Nuk po kërkojmë buxhet shtesë. Ky buxhet është mallra dhe shërbime.

Dhe në bashkëpunim me Qeverinë, janë pajtuar veç ta fusim kod për qasje, se s'ka kod. D.m.th. edhe është i caktuar kodi, edhe ku kanë për t'u marrë mjetet, edhe qysh kanë për t'u shpërndarë dhe kjo është lëshuar, është gabim teknik së pari i Qeverisë, i Ministrisë së Mirëqenies e pastaj edhe i Komisionit për Buxhet dhe Financa. Ju kisha lutur, shikojeni as nuk ka buxhet shtesë, paratë merren në mallra dhe shërbime, por duhet të futet si kod i veçantë, sepse kategoria është e veçantë, edhe ne kemi obligim secili deputetë këtu. Edhe një herë ju falënderoj që keni votuar, por për shkak të pandemisë nuk ka mund të përgatitet prokurimit të shpallë tenderin me këto agjencitë e sigurimeve dhe ka mbetur të vazhdojë në v. 2021. Andaj, ju lutem, ashtu qysh pranuar të hyjnë disa amendamente, futeni këtë amendament në emër të Kuvendit, jo të Besa Gaxherrit, dhe kalojeni.

207 mijë euro. Nëse duhet lexuar, nëse nuk ka nevojë, amendamentin e keni me shkrim, është gjithçka Ok!

KRYETARJA: Unë po pajtohem plotësisht me arsyetimin. Vetëm meqenëse më herët nuk isha këtu. Unë u njoftova që seanca ka votuar që të votohen në pako amendamentet prej 13 e deri në fund. Unë po pajtohem që ka amendamente që do të ishte e arsyeshme të trajtohen në mënyrë të veçantë, sikur kjo që po e propozoni ju. Por për një gjë të tillë, na duhet vendim i seancës.

BESA GAXHERRI: Ok, merreni ju lutem! Unë jam e sigurt se seanca do ta marrë këtë vendim.

KRYETARJA: Para se të kaloj te deputetët e tjerë, më duhet ta sqaroj amendamentin që e propozoi. Faleminderit znj. Gaxherri, do ta shoh tash. Zoti Arben Gashi, amendamentin që e propozuat ju në seancë, sepse keni thënë tërhiqen amendamente e grupit parlamentar. A e sqaroni amendamentin që ju e propozuat? A e tërhiqni apo akoma mbetet? Urdhëro, e keni fjalën, që të mbetet në transkript.

Vetëm një sekondë. E konstatoj se me 86 vota për kanë kaluar amendamentet 1 deri 12. Asnjë votë kundër, asnjë abstenim.

Urdhëro, z. Gashi!

ARBEN GASHI: Faleminderit, kryetare!

Amendamenti mbetet, sepse është amendament i cili bie para në buxhet, e thashë disa herë. Sa u përket amendamenteve të tjera, unë propozova që të gjithë kryetarët e grupeve t'i tërheqin, po nuk i tërhoqi askush. Pra, u votua një mocion tjetër. Kështu që nuk është më, elementi i tërheqjes nuk ekziston, sepse është votuar një mocion, i cili është propozuar nga Komisioni Funkcional. Faleminderit!

KRYETARJA: D.m.th. nuk është tërhequr asnjë amendament, meqenëse s'ka pasur dakordim.

Zonja Hykmete Bajrami e ka fjalën, për amendamentin e propozuar nga znj. Gaxherri.

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, e nderuar kryetare!

E nderuar znj. Gaxherri,

Sapo mora një telefonatë nga Zyra e Kryeministrit. Më thanë që sigurimet shëndetësore do të bëhen nga mallrat e shërbimet nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale. Nuk ka nevojë për kod të veçantë, por blihen sepse të tillat blihen. Kështu d.m.th. e kam informacionin, kështu që nuk ka nevojë premtimi, edhe një herë po ju them është ky.

KRYETARJA: Kemi tash edhe diskutues të tjerë. Bekim Haxhiu e ka fjalën.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, kryetare!

Edhe ju edhe ne jemi deputetë, diskutantët janë në ndonjë debat televiziv. Faleminderit për fjalën!

E para që dua ta sqaroj për juve të nderuar kolegë deputetë, dhe që mbeti pa u sqaruar është se, Komisioni për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale me unanimitet ka votuar sot propozimet, amendamentet për rritjen, dyfishimin e kujdestarisë për infermierët dhe shtesat për specializantët dhe pagesën për ata që kanë përfituar specializimet nga Ministra e Shëndetësisë.

Për fat kë keq, as nuk u diskutua as nuk u hodh në votim propozimi i Komisionit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, i cili ishte propozuar me unanimitet, dhe kryetarja e vuri në dukje edhe një çështje tjetër që është e rëndësishme, sigurisht fibroza cistike.

Por, unë po kërkoj edhe një herë që ajo që është e rëndësishme që dyfishimi i kujdestarisë për infermieret që është propozim edhe i Komisionit për Shëndetësi me unanimitet, të vendoset në votim, sepse është me rëndësi për shëndetësinë dhe punëtorët të cilët janë duke u ballafaquar drejtpërdrejt me pandeminë.

Kemi të bëjmë me tri amendamente, e të cilat drejtpërdrejt merren me këtë çështje.

E dyta, mbeti e pasqaruar çështja dhe propozimi për propozimet që janë për Komunën e Skenderajt, të cilat janë dorëzuar dhe janë amendamentet 76, 77, 78, 79 dhe 81, 82, 83, sepse kishte propozim që këto të mos jenë pjesë e këtij votimi apo propozimi të Komisionit për Buxhet dhe Transfere.

Prandaj, kërkoj që seanca të deklarohet për këto amendamente që e prekin fushën e shëndetësisë dhe që e kanë unanimitetin e Komisionit për Shëndetësi dhe këto të Komunës së Skenderajt.

Kërkoj që të hidhen në votim këto, sepse mbeti propozimi i propozuesit, zotit Haradinaj, pa vendimmarrje nga seanca e Kuvendit.

KRYETARJA: Zoti deputet, vetëm pse unë ju lejoj që ta merrni fjalën, nuk domethënë që duhet ta keqpërdorni edhe tash ta shfrytëzoni...Unë po e di që jemi në prag të fushatës elektorale, por ju kisha lutur, në qoftë se është marrë një vendim i seancës, ta respektoni atë. Kjo ishte e para.

E dyta, ju dje keni shpifur në këtë foltore. Jo, s'ta jap replikë. Unë vendosi a ta jap replikën a jo. Ti, dje ke folur këtu pa prezencën time edhe keni shpifur. Duhet ta pyesësh grupin tënd parlamentar se si janë marrë vendime të caktuara në Kryesi dhe ata ju njoftojnë që unë i kam kundërshtuar ato vendime, e para.

E dyta, keni shpifur duke thënë që unë i marr dy paga. E kjo është një gënjeshtër e madhe. Dhe e treta, keni thënë që unë i kam dhënë vetës pagë të 13-të, e po ashtu është gënjeshtër e madhe.

Kështu që, nuk keni nevojë më që ta keqpërdorni mundësinë që të diskutoni. Jo, s'ka. Po vazhdojmë me deputetët e tjerë. Fjalën e ka deputeti Ekrem Hyseni. Keni abuzuar ti dje, unë sot po të përgjigjem.

EKREM HYSENI: E nderuar kryetare,
Të nderuar kolegë deputetë,

Unë dua të flas për një amendament të cilin e kam paraqitur vet. Ky amendament ka të bëjë me sëmundjen e kancerit në Kosovë dhe ka të bëjë konkretisht me infrastrukturën dhe kushtet të cilat ne duhet tua ofrojmë pacientëve tanë.

Kjo sëmundje është një prej probleme më të mëdha sociale në Kosovë, e cila jep pasiguri sociale të njerëzve të cilët rrezikojnë të sëmurën ose kanë familjarë të tyre të sëmurë.

Meqenëse ne do të donim që t'ju ofronim kushte të cilat njerëzit nuk do t'i detyronin që t'i shisnin shtëpitë e tyre, që dora e shtet nëpërmjet përfaqësuesve të tyre, siç janë deputetët në Kosovë, të realizohej dhe t'ju jepnim shërbime siç duhet, unë do të doja që ky amendament të shqyrtohet, sepse në arsyetimin e Komisionit Parlamentar për Buxhet dhe Financa, ka qenë që nuk ka pasur specifika.

Unë dua t'ju them që specifikat kanë qenë dhe të vetëdijshëm për krizën ekonomike që e kemi tani në pandemi, nuk ka impakt të madh buxhetor, sepse për vitin 2021, ky amendament ka të bëjë vetëm me 1 milion euro me të cilat para do të iniciohej kjo çështje, ku në plan afatgjatë do të siguronte një zgjidhje për problemet e tyre në plan 15 deri 20 vjet.

Pra, që t'u dalim në ndihmë pacientëve me kancer, i lus kolegët deputetë që ta përkrahin këtë amendament. Meqenëse u përmend disa herë fushata, u përmenden populizmat, nëse kalon ky amendament sot, unë publikisht nga kjo foltore dua të deklarohej se nuk do të jem kandidat për deputet, vetëm të kalohet ky amendament dhe me këtë amendament ne do të kishim mundësi t'ju ndihmojmë këtyre njerëzve.

Pra, të kalojë amendamenti, do t'i heqim populizmat. Nëse kalon ky amendament, deklarohej nga kjo foltore se unë nuk do të hyjë kandidat për deputet. Faleminderit!

KRYETARJA: Fitim Uka e ka fjalën.

FITIM UKA: Faleminderit, e nderuar kryetare!

Në fakt, ditën e djeshme më emocionoi jashtëzakonisht shumë kjo thirrja për unitet që e dëgjuam disa herë në këtë foltore, aq sa sot jam zgjuar tepër i lumtur që do të vijmë dhe do ta shohim unitetin e të gjitha subjekteve politike.

Por, e shihni sot këtu që të gjithë i kanë hapur çantat e tyre dhe po bëjnë fushatë politike në kurriz të qytetarëve të Republikës së Kosovës. Është kjo Qeveri e papërgjegjshme, jokushtetuese që ka diskriminuar kategori të punëtorëve shëndetësorë dhe atë jo njëherë, por disa herë.

Atëherë kur Komisioni Parlamentar për Shëndetësi ka arritur njëlloj konsensusi që të paguajë shtesa për punëtorët shëndetësorë në një shumë të caktuar, kjo Qeveri ka negociuar me ta dhe i

ka reduktuar ato. Ndërkaq, sot po na thuhet që nuk ka mjete buxhetore për infermierët, për kujdestaritë e tyre.

Ata vazhdojnë të paguhen vetëm 18 euro për kujdestarinë dhe kanë kërkuar që ajo të dyfishohet. Ka pasur një konsensus në Komisionin Parlamentar për Shëndetësi, por siç shihet këtu nuk ka vullnet prej kësaj Qeverie që ta gjejë një linjë të tillë buxhetore, dhe për më tepër, hapet çanta e buxhetit për kërkesa të tjera të llojllojshme për infrastrukturë, por nuk ka prapë mbështetje për punëtorët shëndetësorë. Këtë turp duhet ta marrë përsipër vetëm kjo Qeveri dhe askush tjetër.

KRYETARJA: Deputetë të nderuar,

Ne kemi votuar propozimin e Komisionit FunkSIONAL. Unë sa u njoftova atë propozim, përveç ndonjë deputetit individualisht, e kanë votuar të gjitha grupet parlamentare. AAK-ja, jo. Në rregull.

Grupet më të mëdha parlamentare, atëherë. Për të qenë më e saktë. Kështu që, po procedojmë me amendamentet e propozuara. Pra, nga numri 13 deri te numri 150. Ashtu siç ka vendosur seanca. Po i presim të kthehen edhe disa deputetë në sallë. Ju lutem që të ktheheni në sallë që të votojmë!

Po e sqaroj pra, për amendamentin që u propozua nga zonja Gaxherri, kemi po ashtu përkushtimin që u dha më herët nga ministrja e Financave, që nga kategoria mallra dhe shërbime, të ndahen me vendim të Qeverisë ato shuma. Në rregull.

Ju lus, përgatituni për votim! Po i vendos amendamentet 13 deri 150, të cilat janë pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Kush është për? Faleminderit! Kush është kundër? A i numëruat? A ka abstenime?

Atëherë, amendamentet në pako nuk kalojnë. Kanë marrë pjesë 71 deputetë. 24 deputetë janë për, 28 kundër dhe 19 abstenime.

Edhe një herë, sa i përket amendamentit të zoti Gashi, meqenëse është i natyrës komplet tjetër, e lus kryetarin e Komisionit FunkSIONAL, zotin Murati, të njoftojë në qoftë se mund të ketë një konsultim të shkurtër me anëtarët e komisionit, dhe ndoshta unë mund t'ju pyes edhe të votoni këtu si komision në qoftë se do t'i jepnit përkrahje këtij amendamenti, sepse është disbursim, domethënë, është me marrë.

Ju lus vetëm anëtarët e komisionit, në qoftë se mund ta autorizoni zotin Murati që ta japë përkrahjen, sepse ky amendament është i natyrës tjetër. Urdhëro, zoti Murati!

HEKURAN MURAT: Faleminderit, e nderuar kryetare!

Meqenëse kemi të bëjmë me një marrëveshje ndërkombëtare që u miratua dje, pra që pritet të hyjë në fuqi edhe që efektet duhet të vërehen, po ashtu edhe në buxhet, përndryshe nuk do të kishte kuptim miratimi i asaj marrëveshjeje, po besoj e kam miratimin e të gjithë anëtarëve të komisionit që ta trajtojmë si të miratuar në komision.

Mirëpo, nëse është nevoja mund të bëjmë edhe shmangie të Rregullores që të trajtohet ky amendament në seancë. Pra, cilido opsion, konsideroj që e ka mbështetjen e Komisionit Funkcional për ta trajtuar dhe për ta përfshirë në buxhet.

KRYETARJA: Në rregull. Tani do t'i pyes të gjithë deputetët se kush është për, që këtë amendament ta fusim? Faleminderit! A ka kundër? Nuk ka. A ka abstenime? Nuk ka.

Meqenëse kalon propozimi për futje në rend të ditës, tash duhet ta qesim amendamentin në votim. Kush është për? Ministrja po na incizon në këtë moment uniteti të plotë. Faleminderit! A ka kundër? Nuk ka. Abstenime a ka? Nuk ka.

Konstatoj se me shumicë absolute kalon amendamenti i propozuar nga Arben Gashi. Ju lus ta dërgoni edhe me shkrim, meqenëse e keni lexuar më herët.

Tani do ta votojmë tekstin e projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara. Lus deputetët që me ngritje dore të deklarohen për projektligjin.

Kush është për? Kush është kundër? Nuk ka! A ka abstenime? Nuk ka! Faleminderit!

Po pres numërimin e votave.

Konstatoj se me 85 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, Kuvendi e miratoi Ligjin nr. 07/L-041 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Si njoftim, na ka ardhur një propozim për zgjedhjen e kryetarit të Bordit të Ankesave të Mediave, na erdhi tani.

Nuk e di në qoftë se ka gatishmëri të grupeve parlamentare. Në rregull. Meqenëse procedurat kanë përfunduar, konstatoj se Kuvendi në seancat plenare të mbajtura me rastin së zgjedhjes së anëtarëve të Bordit të Ankesave, 3 anëtarë të Bordit për Ankesa: Avdyl Hyseni, Ylber Fetahu dhe Ilaz Rudaku, kanë kërkuar me shkrim nga Kuvendi që ta zgjedhë kryetarin e bordit.

Ilaz Rudaku ka mandat deri më 15 mars 2021. Zoti Hyseni dhe zoti Fetahu janë zgjedhur më 29 tetor 2020 dhe kanë mandat deri më 29 tetor 2021 dhe njëri prej tyre duhet të zgjidhet kryetar.

Të votohet nga Kuvendi, anëtari që ka marrë më së shumti vota. Në këtë rast, Avdyll Hyseni i ka marrë 49 vota, kurse Ylber Fetahu 56 vota. Kërkohej që deputetët të deklarohen me votim për anëtarin Ylber Fetahu, i cili ka marrë më së shumti vota.

Nuk po shoh që deputetët janë gati. Meqenëse i ka marrë 56 vota, po konstatoj që Ylber Fetahu do të jetë kryetar i bordit.

Meqenëse kjo mund të jetë seanca jonë e fundit, më lejoni që t'ju dëshiroj të gjithëve në radhë të parë shëndet, sepse kjo është më e rëndësishmja dhe po ashtu shpresoj që të kemi para nesh një proces zgjedhor, ku respektohet vota e qytetarëve të cilët i përfaqësojmë.

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*